

KUSHTET E PERGJITHSHME

OBJEKTI I SIGURIMIT

1. Objekt i kesaj kontrate eshte sigurimi i pergjegjesise te drejtuesit te mjetit motorrik per demet qe ky drejtues mund t'i shkaktoje paleve te treta nga perdorimi i ketij mjeti, si rrjedhoje e veprimeve ose mosveprimeve te tij me faj, ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr.10 076, date 12.02.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit" dhe Rregullores nr. 53, date 25.06.2009 « Per trajtimin e demeve qe mbulohen nga kontrata e sigurimit te detyrueshem ne sektorin e transportit". Ne zbatim te ligjit te mesiperm dhe brenda kufijve te percaktuar, lidhur me demin pasuror dhe demin jopasuror, ne rast vdekjeje, te demtimeve trupore dhe perkeqesimit te shendetit te shkaktuar paleve te treta. Këtu përfshihen edhe dëmet jo pasurore që pësojnë pasagjerët në mjetet motorrike të destinuar për transportin e tyre. Sendet dhe objektet e përdorimit të zakonshëm, të cilat për vetë natyrën e tyre mbahen me vete nga personat që transportohen, janë objekt i këtij paragrafi.
- Kjo kontrate sigurimi mbulon pergjegjesine e te siguruarit ndaj paleve te treta per deme te ndodhura vetem ne territorin e Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

2. Sigurimi i pergjegjesise te mbajtesve te mjeteve motorik nuk mbulon demet e sendeve, te cilat i ka marre persiper t'i transportoje mbajtesi i mjetit, shkaktar i aksidentit dhe qe ndodhen ne mjet ne castin e ndodhjes se aksidentit.
3. Pergjegjesia e pronarit te mjetit motorik zbatohet per demet e shkaktuara si nga mjeti terheqes, edhe nga mjeti i terhequr.
4. Llogaritja e mases se demshperblimit ndaj paleve te treta, per detyrimin qe buron nga kjo police sigurimi, per demin e shkaktuar ne nje aksident, kryhet vetem mbi bazen e Ligjit 10 076 date 12.02.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit" dhe Rregullores nr. 53 date 25.06.2009 " Per trajtimin e demeve qe mbulohen nga kontrata e sigurimit te detyrueshem ne sektorin e transportit" ne zbatim te ligjit te mesiperm.
5. Ne te gjitha ato raste kur mjeti motorrik i jepet ne perdorim nje personi, emri i te cilit nuk eshte shkruajtur ne policen e sigurimit, pronari i mjetit duhet te marre nje leje paraprake me shkrim per dhenie autorizimi nga Shoqeria e Sigurimit qe ka leshuar policen, e cila lejon dhenien e autorizimit per perdorimin e mjetit nga personi tjetër si dhe tarifimin shtese perkates per sigurim, sipas parimit bonus-malus.

PERJASHTIMET NGA MBULIMI NE SIGURIM DHE PERJASHTIMI NGA DEMSHPERBLIMI.

6. Nuk perfiton nga kjo kontrate sigurimi:
 - a) drejtuesi i mjetit, shkaktar i aksidentit, përfshirë këtu trashëgimtarët ligjorë të tij, për dëme pasurore dhe jopasurore shkakuar nga aksidenti këtij drejtuesi;
 - b) pronari, bashkëpronari dhe çdo përdorues tjetër i mjetit, shkaktar i aksidentit, për dëmet që ata vetë pësojnë nga ky aksident;
 - c) çdo pasagjer, që ndodhet me vullnetin e vet në mjetin motorik, shkaktar të aksidentit, të drejtuar nga një drejtues i paautorizuar, kur provohet se pasagjeri ishte në dijeni të këtyre rrethanave;
 - ç) çdo pasagjer, që ndodhet me vullnetin e vet në një mjet të pasiguar, shkaktar të aksidentit, kur byroja provon se pasagjeri ishte në dijeni të kësaj rrethane;
 - d) personi, i cili ka përvetësuar mjetin motorik në mënyrë të kundërligjshme dhe është dëmtuar gjatë përdorimit të këtij mjeti;
 - dh) personi i dëmtuar në këto raste:
 - i) për shkak të përdorimit të një mjeti në ngjarje sportive në rrugë apo pjesë rrugësh, të palejuara për drejtim të mjetit, për arritjen e shpejtësive mesatarisht të larta apo për t'u stërvitur për gara;
 - ii) për shkak të pasojave të energjisë bërthamore gjatë transportit të materialeve radioaktive;
 - iii) për shkak të veprimeve të luftës, revoltave apo akteve terroriste, me kusht që shoqëria e sigurimit të provojë se dëmi është shkakuar nga ngjarje të tilla.
 - e) drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin, për të cilin ai është i destinuar të përdoret;
 - ë) drejtuesi nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorik, sipas kategorisë apo tipit të mjetit, përveç rasteve të përdorimit gjatë mësimëve të drejtimit të mjetit, kur ky drejtohet nga kandidati drejtues, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimin;
 - h) drejtuesit të mjetit motorik i është konfiskuar leja e drejtimit, i është ndaluar të drejtojë tipin dhe kategorinë e mjetit apo i është ndaluar përdorimi i lejes së drejtimit, të leshuar nga një shtet tjetër për në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - i) drejtuesi drejton mjetin motorik nën ndikimin e alkoolit, mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psikoaktive;
 - j) drejtuesi e shkakton dëmin qëllimisht;
 - k) aksidenti ndodh për shkak të defekteve të ndjeshme teknike të mjetit dhe drejtuesi ka qenë në dijeni të këtyre rrethanave.

DISPOZITA TE TJERA

7. Afati i parashkrimit te pales te trete te demtuar per kerkimin e demshperblimit nga shoqeria e sigurimit eshte 2 vjet nga dita e ndodhjes te aksidentit ne baze te nenit 115 shkronja ç) te Kodit Civil te Republikes te Shqiperise.
- 8 Ne zbatim te nenit 12 te Ligjit nr.10 076 date 12.02.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit", pala e demtuar i drejtohet me kerkese per demshperblim shoqerise te sigurimit. Vetem pas marrjes te pergjigjes, pala e demtuar qe ka pretendime mund ti drejtohet gjykates me padi civile.
9. I Siguruarit është i detyruar të njoftojë Rastin e Sigurimit menjehere por jo me vonë se 72 orë nga momenti i ndodhjes së tij ose nga dita në të cilën ka marrë dijeni, prane shoqerise sigurimit.
10. Për të dëmtuarit që përfitojnë nga sigurimi do të mbulohen shpenzimet mjekësore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm në rast se janë rekomanduar për kurim jashtë vëndit nga Komisioni Mjekësor Zyrtar i ngritur për këtë qëllim nga Ministria e Shëndetësisë. Komisioni Mjekësor Zyrtar arsyeton mbi mundësinë e e kurimit të të dëmtuarit brënda apo jashtë vëndit dhe shprehet për rastet kur është i nevojshëm kurimi jashtë vëndit, duke rekomanduar edhe klinikën që do të përdoret. Për çdo të dëmtuar, Shoqëria e Sigurimit duhet të bjerë dakort rast pas rasti pas marrjes së rekomandimit të Komisionit Mjekësor Zyrtar për klinikën që merr përsipër kurimin, për çmimin për çdo ditë qëndrimi të të dëmtuarit dhe shoqëruesin e tij, llojin e ndërhyrjeve, numrin e tyre, çmimin për çdo ndërhyrje dhe afatin e kurimit.
Verifikoni policen tuaj te sigurimit TPL duke kontaktuar ne konsumatori@amf.gov.al dhe ne nr. e telefonit: 0800 69 69
11. "Te dhenat personale te mbledhura nepermjet kesaj do te perdoren ne administrimin e kontrates se sigurimit, per dhenien e sherbimeve ndaj te siguruarit dhe perfituesit,perfs hire trajtimin e demit, ne zbatim te ligjit nr.10076 date 12.02.2009" Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit".
Shoqeria e sigurimit (emri i shoqerise) realizon transferimin e te dhenave personale tek te trete per qellime te sigurimit apo biznesit sipas specifikimeve te ligjit. Ne lidhje me te dhenat personale te mbledhura dhe perpunimin e tyre, klienti ka te drejte te ushtroje te drejten e aksesit dhe te drejten e tjera te parashikuara ne ligjin nr 9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale "I ndryshuar".